



Rrjeti CSR
Kosova
Buletini Informativ

Adresa: Rruga "Tringë Smajli".nr 21 Prishtine Republika e Kosovës 10000
 E-mail: info@csrkosovo.org
 Tel: +383 38 712 715
 Web: www.csrkosovo.org
 LinkedIn & Facebook: Kosovo CSR Network
 Instagram: csrkosova

CSR Kosova pjesë e CSR Europe



Projekti LAB nga Sharrcem në komunën e Hanit të Elezit

Kompania anëtare e rrjetit, Sharrcem, në tre vitet e fundit ka qenë shtetese kryesore në krijimin e 78 bizneseve të prodhimit të fermave familjare në komunën e Hanit të Elezit, duke ndermarre kështu veprime të CSR për të adresuar sfidat në ambientin ku ata veprojnë. Projekti LAB i Sharrcem, i bashkëfinancuar nga USAID ka fuqizuar dukshëm sektorin e Bujqësisë në komunën ku ata operojnë. Ata gjithashtu kanë kontribuar në ndihmën teknike dhe mobilizimin e pronarëve të tokave drejt rinovimit të prodhimit tradicional të bujqësisë në bujqësi intensive, duke perzgjedhur edhe fushat me potencial për zhvillim. Kontributi i Grupit Titan Sharrcem është 138,794.58 euro dhe kontributi i Programit USAID AGRO ishte 79,572.85 euro. Duhet të theksohet se një kontribut i rëndësishëm i suksesit të projektit LAB shkon në 78 përfitues dhe anëtarët e familjes së tyre për angazhimin e tyre për të aplikuar njohuritë e fituara përmes leksioneve dhe asistencës teknike në terren.



“Dhuro Gjak, Shpëto jetë”

Për shkak se nevoja për gjak është konstante, në vazhdimësi ka nevojë edhe për dhurim të gjakut. Çdo ditë, të gjitha spitalet dhe klinikat në botë kanë nevojë për gjak dhe përbërës të gjakut për të trajtuar pacientët, pasi që shumica e ndërhyrjeve kirurgjikale dhe një numër i madh i procedurave mjekësore kërkojnë transfuzion gjaku.

Anëtarët e Rrjetit CSR Kosova inkurajojnë në vazhdimësi stafin e tyre të japin këtë kontribut të vogël për shoqërinë, duke u bërë pjesë e iniciativave për dhëniën vullnetare të gjakut. Këto iniciativa kanë për qëllim të vetëdijësojnë të tjerët për dhurim të gjakut ashtu që rastet me nevojë në qendrat spitalore të kenë qasje në transfuzion të gjakut. Në fotografitë poshtë janë stafi i anetareve të CSR Kosova: nga Recura, Oda Ekonomike e Kosovës, dhe Sharrcem.



RECURA FINANCIALS



SHARRCEM



ODA EKONOMIKE E KOSOVËS

Menaxhimi i qëndrueshmërisë dhe përgjegjësia korporative në Raiffeisen Bank në Kosovë


Raiffeisen Bank në Kosovë ka integruar masa gjithëpërfshirëse të qëndrueshmërisë në veprimtarinë e saj të biznesit. Parimet e saj themelore rrjedhin nga idetë e themeluesit Friedrich Wilhelm Raiffeisen; për të, solidariteti social, vetë-ndihma dhe qëndrueshmëria ishin udhëzime për aktivitetin ekonomik. Ne e konsiderojmë veten një forcë të madhe ekonomike në Kosovë dhe vende të tjera ku Raiffeisen është i pranishëm dhe kështu ne vlerësojmë qeverisjen e qëndrueshme të korporatave dhe përgjegjësinë shoqëruese shoqërore që shkon me të.

Roli ynë në ekonomi karakterizohet nga përgjegjësia praktike ndaj klientëve tanë, punonjësve, aksionarëve dhe shoqërisë.

Raiffeisen Bank në Kosovë është e angazhuar për të harmonizuar strukturat dhe proceset e saj të menaxhimit me këtë qëndrim. Në

tre fushat e qëndrueshmërisë të "Bankierit përgjegjës", "Partner i drejtë" dhe "Qytetar i angazhuar", të cilat janë të lidhura ngushtë me aktivitetet e saj të biznesit, Banka përpiqet që të aplikojë në mënyrë optimale vlerat dhe aftësitë e saj për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm në kompani dhe në shoqëri.

Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia korporative janë komponentë kyç të identitetit tonë dhe kanë jetuar si pjesë e kulturës së korporatës. Qëllimi i synuar si një kompani është që të veprojë përgjegjës që shtrihet përtej masave individuale. Menaxhimi i qëndrueshmërisë është përgjegjës për planifikimin strategjik dhe organizativ dhe zbatimin e të gjitha iniciativave të qëndrueshme relevante. Kjo përfshin fushat e "ekonomisë / biznesit bazë", "ekologjisë", "burimeve njerëzore" dhe "angazhimit social" për RBI dhe bankave të rrjetit në Evropën Qendrore dhe Lindore.



Our approach as designers of a sustainable company and society

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Rëndësia e Tyre (SDG)

Bashkësia ndërkombëtare (UN) ka miratuar 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) në shtator të 2015. Objektivat, që tregohen në fotografine poshte, bazohen në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të cilat kanë zgjatur nga 2000 deri në 2015, por janë më gjithëpërfshirëse. Krerët e vendeve të ndryshme kanë adaptuar keto në strategjite e tyre zhvillimore, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm për vendet e tyre. UNDP është një nga organizatat kryesore që punojnë për të përbushur SDG-të, dhe kete plan ambicioz, deri në vitin 2030.

Identifikimi i SDG-ve tani është prioriteti më i madh i CSR Europe, anetare e të ciles është Rrjeti CSR Kosova, dhe për deri sa secila nga 17 SDG-të është e rëndësishme, shtete të ndryshme varësisht nga faza e zhvillimit që ato gjenden, kanë prioritete të ndryshme. Në menyre që aktivitetet tona të jene në përputhje me SDG me me prioritet, ne si Rrjeti nacional i Kosovës për CSR do të identifikojmë prioritetet për Kosovën së bashku me palët e interesit (sektori publik, organizatat e huaja, sektori privat, shoqëria civile etj.) dhe të identifikojmë veprimet dhe synimet që duhet të kemi t'i ndërmarrim drejt arritjes së tyre.



Dita Botërore e Mjedisit

Dita Botërore e Mjedisit (WED) ndodh në 5 Qershor të çdo viti dhe është mjete kryesor i Kombeve të Bashkuara për nxitjen e vetëdijes dhe veprimit për mbrojtjen e mjedisit. Në emër të Ditës Botërore të Mjedisit, më 5 qershor, Sharrcem - Departamenti i Mjedisit zhvilloi takime të përbashkëta me përfaqësuesit e Bashkisë së Hanit të Elezit dhe akterë të tjerë relevantë, në mbështetje të iniciativës "Lidhja e njerëzve me natyrën" - e cila është e temë globale e këtij viti për Ditën Botërore të Mjedisit 2018.

Sharrcem u bashkua në mbështetje të këtij aktiviteti duke ofruar burime dhe materiale në natyrë, të cilat ishin një ndihmë e lartë për zhvillimin e fushatës, si qese letre, dorëza etj. Sharrcem, si një kompani përgjegjëse ndaj mjedisit, u bashkua duke mobilizuar qytetarët e Hanit të Elezit, së bashku me institucione dhe akterë të ndryshëm, duke pastruar deponitë e paligjshme në komunën e



Hanit të Elezit, të cilat kryesisht janë krijuar pranë lumit Lepenc.

Banka ProCredit mbështet ndërtimin e qendrës “Thesarët e Natyrës”

Banka ProCredit ka mbështetur ndërtimin e Qendrës për Edukim Mjedisor në kuadër të Pyllit të Arinjëve e cila ka për qëllim të promovojë mbrojtjen e ambientit, duke financuar lidhjen e qendrës me sistemin e furnizimit me rrymë dhe instalimin e paneleve solare fotovoltaike në shumë prej 67.000 Euro.

“Për bankën ProCredit, ky projekt është i një rëndësi të veçantë meqë në njërin anë shprehë dedikimin e vazhdueshëm të bankës në mbrojtje të mjedisit, element i pandarë i identitetit tonë dhe në anën tjetër konfirmon tutje pozicionin tonë për përgjegjësi sociale” është shprehur drejtori gjeneral i bankës ProCredit Ilir Aliu.



Dorëzohet aparati i bilirubinës në Klinikën e Neonatologjisë

Banka Raiffeisen, në bashkëpunim me Aksionin për Nëna dhe Fëmijë, ka dorëzuar pajisjen 'Bilirubinometria transkutane', në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, pranë Klinikës së Neonatologjisë. Bilirubinometria transakute është pajisje mjekësore e cila përcakton vlerat e bilirubinës te foshnjat, me të cilën pastaj mundësohet parandalimi i pasojave të hyperbilirubinisë me kosto më të ulët, shpejt, pa dhimbje dhe pa mundësi infeksionesh. Banka Raiffeisen vazhdimisht i ka kushtuar vëmendje të veçantë përkrahjes së shëndetësisë.



Gjysmë maratona “Vrapo për paqe dhe tolerancë”

Me moton “Vrapo për paqe dhe tolerancë”, kompanitë anëtare të rrjetit, Korporata Rugovë dhe Banka Procredit mbështetën gjysmë-maratonën e cila u mbajt në Prishtinë. ProCredit dhe Rugovë janë mbështetëse tradicionale të kësaj ngjarjeje të rëndësishme sportive në vend, e cila kontribon në imazhin e sportit të Kosovës.



Meridian Express mbështet garën e Triathlon-it (not, çiklizëm dhe vrapim) në Prishtinë

Gërmia 555 në mbështetje të Meridian Express, për të parën herë në Kosovë, organizon “Triathlon-in” në pishinën e Gërmisë me 19 Gusht, 2018 në Prishtinë. “Triathlon-i” është gara e notit e cila përfshinë tri disciplina, përkatësisht atë në 300m not, 8km çiklizëm dhe 3km vrapim. Ngjarja e parë moderne për not, biçikletë, vrapim e quajtur “triathlon” u mbajt në Mision Bay, San Diego, Kaliforni më 25 shtator 1974. Triathlon-i është gara më e gjatë dhe më e vështira që përfshin 3.8km not, 180 km çiklizëm dhe 42.195km vrapim (maratonë e plotë). Në Prishtinë për herë të parë kjo garë po organizohet me iniciativën e Klubit Gërmia555, me mbështetjen e plotë të Meridian Express në distancat prej 300m në not, 8km në çiklizëm dhe 3km në vrapim.

Mbështetës i këtyre garave unike që po mbahen në Prishtinë, Meridian Express është rrjeti i marketeve në Kosovë, si dhe njëra ndër kompanitë më të mëdha tatimpaguese në vendin tonë. Sporti, përveç efekteve argëtuese tek masa, është i rëndësishëm për secilën shoqëri meqë përcion mesazhin për një jetë të shëndetshme dhe me plot aktivitete. Meridian Express ofron kontribut të vazhdueshëm në gjitha fushat sportive si: futboll, futsal, basketboll, volejboll, hendboll e të tjera.

Gjithashtu, klubi Gërmia555 dhe Meridian Express, synojnë promovimin e Prishtinës si destinacion turistik dhe sportiv përmes këtij aktiviteti i cili tashmë organizohet në të gjitha kryeqytetet e rajonit, përveç Prishtinës.



Meridian Express Tournament 2018



Meridian Express Tournament 2018 mbledh mbi 50 skuadra në turneun më të madh të futbollit në qytet. Si organizatorë dhe mbështetës të këtij turneu të madh, Meridian Express e ndan pasionin e njëjtë për futbollin dhe dëshiron që këtij sporti t'i jap shijen e fitores, respektit dhe dashurisë për garën por edhe fituesit e saj. Prandaj është viti i dytë me radhë që Meridian Express e mbështet këtë organizim, i cili mbledh qindra futbolldashës nga gjitha sferat e shoqërisë tonë.



Përgatitur nga Oda Ekonomike Amerikane për Rrjetin CSR

Realizuese: Jora Lumezi